



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 545, datë 29.9.2021

P Ë R

**KRYERJEN E PAGESËS TË DOZAVE TË VAKSINAVE
DHE TË PAGESAVE RESPEKTIVE QË RRJEDHIN NGA AKTI
NORMATIV NR.30, DATË 27.9.2021, I KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA
NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN
NGA DHE NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V. DHE MINISTRISË
SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT
TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NOMATIV NR.3,
DATË 18.1.2021”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr.30, datë 27.9.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kryerjen, nga Instituti i Shëndetit Publik, të pagesave të përcaktuara në aktin normativ nr.30, datë 27.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ

nr.3, datë 18.1.2021”, në vlerën 6 009,120 (gjashtë milionë e nëntë mijë e njëqind e njëzet) USD, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të ditën e pagesës.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2021, në llogarinë ekonomike 6050000 (produkti 91305AH) të programit “Shërbime të shëndetit publik” (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë i shumës prej 6 009,120 (gjashtë milionë e nëntë mijë e njëqind e njëzet) USD-sh, për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinës nga kompania *Pfizer Export B.V.*
3. Fondi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.
4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU

NR.PROT. 4577/1
DATE 30.9. 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

